



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2021:113147

Datë: 15.05.2024

Numri i dokumentit: 05689775

**NË EMËR TË POPULLIT**

P.nr.248/21

GJYKATA THEMELORE MITROVICE, DEGA NË VUSHTRRI-Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Ferki Xhaferi, me pjesëmarrjen e praktikantes Diana Fejza në çështjen penale kundër të pandehurit E.A nga fshati ..., Komuna Skenderaj, te cilin sipas autorizimit e mbron av. Naser Azemi, për shkak të veprës penale *Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm* nga neni 356 par. 1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr. 1090/20 të datës 11.06.2021 pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar publik të datës 08.05.2024, në praninë e prokurores së shtetit, të pandehurit, në të njëjtën datë, mori dhe shpalli, kurse me dt. 15.05.2024 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

I PANDEHURI: E.A nga i ati I, e ëma B,e vajzërisë H, i lindur me ... në fshatin ..., Komuna Skenderaj ku edhe tani jeton në rr. ... nr...., ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i pa martuar i gjendjes së mesme ekonomike, shtetas i Republikës së Kosovës.

**Ë S H T Ë F A J T O R**

SEPSE: Me datë 08.05.2020 rreth orës 11:15 në fshatin ..., Komuna e Vushtrrisë, në cilësinë e koordinatorit për prishje pran KEDS-it, njësia në Vushtrri, nuk ka mirëmbajtur në gjendje të rregullt rrjetin elektrik, andaj në ditën e cekur D.S me vendbanim në ... duke drejtuar kamionin e tipit MAN, ngjyrë të kaltër, me targa të regjistrimit ..., duke kaluar në rrugën e fshatit ..., me pjesën e sipërme të rimorkios së kamionit e kap një kabllo, i cili ishte në lartësi me te ulët se kamioni, përkatësisht nuk ishte në lartësinë e kërkuar sipas standardeve, i njëjti e kap dhe e tërhjek dhe e njëjta kabllo e shkëput shtyllën elektrike nga betoni dhe aty shkëputen përçuesit ajror të cilit ishin në atë shtyllë, në këtë mënyrë shkaktohet dëmi në vlerë prej 682.20€ euro.

Më këtë ka kryer veprën penale *Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm* nga neni 356 par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në kuptim të neneve 4, 7, 17, 38, 47, 48, 69, 70, dhe nenit 356 par.1 të KPRK-se, si dhe në bazë të nenit 364, 449, 463, të KPP-së të pandehurit i shqipton:

## DËNIM ME KUSHT

Me të cilin të pandehurit E.A gjykata i vërteton dënimin me burg në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj i cili dënim nuk do të ekzekutohet në qoftë se i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale në periudhën verifikuese prej një (1) viti.

DETYROHET i pandehuri që në emër të shpenzimeve procedurale të paguaj, në emër të shpenzimeve paushallë shumen prej tridhjetë (30€) dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumen prej njëzet (20€).

Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasuroro juridike udhëzohen në kontest civil.

Të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

## A r s y e t i m

### *Pjesa hyrëse e aktgjykimit të arsyetuar*

Prokuroria Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.1090/20 të datës 11.06.2021, kundër të pandehurit E.A, nga fshati ..., Komuna e Skenderaj për shkak të veprës penale *Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm* nga neni 356 par.1 të KPRK-së me të cilën aktakuzë, prokurori i shtetit ka kërkuar nga gjykata që pas mbajtjes së shqyrtimit të pandehurin ta shpallë fajtorë dhe ti dënojë sipas ligjit.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar në këtë çështje penale me datë 08.05.2024, në të cilën seancë kanë marrë pjesë prokurorja e shtetit Vyrtyte Gervalla, i pandehuri E.A si dhe mbrojtësi i tij ma autorizim av.Naser Azemi.

### *Deklarimi i të pandehurit lidhur me fajësinë*

Gjyqtari i vetëm gjykues e ka njoftuar të pandehurin me të drejtat e tij dhe pasi që gjykata është bindur se i pandehuri i ka kuptuar udhëzimet e gjykatës, pas leximit të aktakuzës, i është dhënë mundësia që të deklarohet lidhur me pranimin ose jo të fajësisë.

I pandehuri E.A ka deklaruar se e pranon fajësinë në tërësi sipas aktakuzës dhe ka shtuar se ka qenë një gabim i vogël që ka ndodhur, nuk ka qenë e qëllimshme asgjë, ka kërkuar falje gjykatës dhe të gjithë atyre që janë dëmtuar.

### *Deklarimet e palëve lidhur me fajësinë*

Prokurorja e shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se në bazë të deklarimit të të pandehurit përkitazi me aktakuzën, gjykatës i ka propozuar që ta aprovojë pranimin e fajësisë, pasi që është në përputhje me provat që gjenden në shkresat e lëndës e po ashtu janë plotësuar kushtet ligjore të cilat parashihen me dispozitat e KPPRK-së e që i referohen institutit të pranimit të fajësisë si dhe ka propozuar gjykatës si rrethanë lehtësuese të merret pranimi i fajësisë si dhe pendesa e shprehur nga ana e të pandehurit në këtë seancë gjyqësore, duke shtuar se nga gjykata kërkon që sipas detyrës zyrtare të pajiset me certifikatë lidhur me të kaluarën eventuale kriminale për të pandehurin dhe varësisht se çka rezulton nga ajo, të njëjtin të e marrë si rrethanë rënduese respektivisht lehtësuese, ndërsa rrethana rënduese lidhur me këtë çështje penale prokurorja e shtetit ka deklaruar se nuk kanë gjetur.

Mbrojtësi i të pandehurit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se pas konsultimit të mjaftueshëm më të mbrojturin e tij, i njëjti e pranon fajësinë në mënyrë vullnetare dhe të singërte sikurse në aktakuzë, andaj gjykatës i ka propozuar që me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të pandehurit ti ketë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese kjo për faktin se vepra është kryer nga pakujdesia, duke shtuar se i mbrojturi ka kërkuar falje të dëmtuarit si dhe gjykatës se i njëjti është mbajtës i familjes dhe vazhdimisht kujdeset për prindin e tij i cili është i shtyrë në moshë gjegjësisht 87 vjeçar. Tutje mbrojtësi i të pandehurit i ka propozuar gjykatës që ndaj të njëjtit të shqiptoj një dënim sa më të butë, duke qenë se i pandehuri nuk ka të kaluar kriminale.

#### *Vlerësimi i gjykatës lidhur me plotësimin e kushteve për pranimin e fajësisë*

Gjykata, duke vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka gjetur se pranimi i fajësisë është në pajtim me nenin 242 të KPPRK-së, kjo pasi që i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, se aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, që do të bënin të pamundur që gjykata të bëjë vlerësimin e pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit.

#### *Provat e vlerësuara nga gjykata*

Gjykata ka konstatuar se pranimi i fajësisë është i mbështetur edhe në provat materiale të cilat mbështesin aktakuzën dhe atë: raporti fillestar i incidentit me numër të rastit 2020-BD-310 i datës 08.05.2020;raport i oficerit 2020-BD-310 i datës 08.05.2020;raport policor i datës 08.05.2020;procesverbal i marrjes në pyetje të dëshmitarit J.T i datës 08.05.2020;procesverbal i marrjes në pyetje për të dyshuarin E.A i datës 08.05.2020;foto dokumentacion ne 15 shtojca; ekspertizë e datës 07.06.2020.

#### *Gjendja faktike e vërtetuar*

Gjyqtari i vetëm gjykues bazuar në provat që gjenden në shkresat e lëndës dhe në deklarinimin e vetë të pandehurit, ka vërtetuar këtë gjendje faktike, se i pandehuri E.A ka kryer veprën penale *Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm* nga neni 356 par.1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në nenin 356 par.1 të KPRK – së është parashikuar forma themelore e veprën penale *Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm*, të cilën e kryen: “*Kushdo që me anë të zjarrit, vërshimeve, armëve, eksplozivit apo ndonjë mjete tjetër vdekjeprurës, helmit ose gazit helmues, rrezatimit jonizues, forcës mekanike, me energji elektrike ose me ndonjë lloj energjie tjetër, ose me ndonjë veprim tjetër të rrezikshëm apo mjete të rrezikshme, shkakton rrezik të madh për jetën e njerëzve apo dëm të konsiderueshëm pasuror, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.*”.

*Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit*

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata duke u bazuar në dispozitat e nenit 38, 69 dhe 70 të KPRK-së, ka marrë parasysh por pa u kufizuar në rrethanat lehtësuese si: pranimin e fajësisë nga i pandehuri, rrethanat personale, faktin se i njëjti ka kërkuar falje të dëmtuarit, është mbajtësi i familjes, kujdeset për prindin e moshuar, dhe faktin se i njëjti nuk ka rënë më parë ndesh me ligjin, ndërsa sa i përket rrethanave renduese gjykata rrethana renduese në rastin konkret nuk gjeti.

Gjykata çmon se dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit, është i drejtë dhe i ligjshëm, në harmoni me rrethanat e kryerjes së veprave, shkallën e përgjegjësisë penale të të pandehurit dhe intensitetin e dëmtimit të vlerës së mbrojtur.

Gjithashtu duke pasur parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, gjykata ka vlerësuar se nuk ka pasur vend që të pandehurit t’i shqiptohet dënim më i rëndë apo më i butë, dhe se me dëmtimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitat e nenit 38 të KPRK-së dhe atë që të parandalojë kryerësin nga kryerja e veprave tjera penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin në rastin konkret, që i pandehuri në të ardhmen të ketë kujdes të shtuar, që të mos bie në kundërshtim me ligjin, dhe t’i parandaloje personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

*Arsyet lidhur me kërkesën pasurore juridike, shpenzimet e procedurës dhe kompensimin e viktimave të krimit.*

Vendimin për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil gjykata e morri në bazë të nenit 462 të KPRK-së, i cili parasheh se: “*Në aktgjykim me të cilin i akuzuari shpallet fajtor, gjykata mund të vendosë për kërkesën pasurore juridike të dëmtuarit në tërësi ose pjesërisht dhe për pjesën e mbetur e udhëzon në kontest civil. Kur të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtëm, gjykata e udhëzon të dëmtuarin që tërë kërkesën pasurore juridike mund ta realizojë në kontest civil apo të paraqes kërkesë në Programin për Kompensim të Viktimave nëse i plotëson kushtet e atij programi.*”

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e morri në bazë të nenit 452 par.4 të KPRK-së, ndërsa vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e morri në bazë të nenit 36 par.3 pika 3.1 të Ligjit nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Nga të lartcekurat e bazuar në nenin 364 të KPPRK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE MITROVICË DEGA NË VUSHTRRI  
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal  
P.nr. 248/21 datë 15.05.2024

Procesmbajtësja-praktikantja  
Diana Fejza

Gjyqtari i vetëm gjykues  
Ferki Xhaferi

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta në ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë nëpërmes kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme.